



Buletini

- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitete tjera

Prill 2017

Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm

Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendi dhe veprimtaria e rrezikshme

Më 05 prill 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendi dhe veprimtaria e rrezikshme”.

Ky trajnim kishte për qëllim që, gjyqtarët e fushës civile të avancojnë njohuritë e tyre lidhur me përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga sendi dhe veprimtaria e rrezikshme.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtua përgjegjësia për dëmin nga sendi dhe veprimtaria e rrezikshme, kushtet për kompensimin e këtij dëmi dhe kushtet për lirimin nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm dhe veprimtari të rrezikshme. Në pjesën e dytë të trajnimit, u trajtuan llojet veçanta të përgjegjësisë për kompensimin e dëmit nga sendi dhe veprimtaria e rrezikshme dhe raste nga praktika gjyqësore.

Gjithashtu u trajtua edhe zbatimi i drejtë i dispozitave të Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, që rregullojnë përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga sendi dhe veprimtaria e rrezikshme, përgjegjësinë për marrjen e

kundërligjshme të sendit të rrezikshëm nga zotëruesi, përgjegjësinë për dorëzimin e sendit personit të tretë, përgjegjësinë për të metat e produkteve dhe rastet e veçanta të përgjegjësisë.

Tema e shqyrtuar ishte me interes, marr për bazë numrin e rasteve dhe dilemave në praktikën gjyqësore që i referohen kërkesave për shpërblim të dëmit nga këto baza. Pjesëmarrësit thelluan njohuritë e tyre lidhur me interpretimin e drejt të dispozitave ligjore për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga sendi dhe veprimtaria e rrezikshme, analizën dhe zbërthimin në situatat kur nuk ka përgjegjësi civile mbi këtë bazë dhe vlerësimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit mbi bazën e përgjegjësisë objektive.

Në trajnim u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike të përcjella me shembuj praktik.

Përfitues ishin gjyqtarë të Gjykatës së Apelit, gjyqtarë të divizionit civil të Departamentit të Përgjithshëm të gjykatave themelore, si dhe bashkëpunëtorë profesional.



Mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve

Më 07 prill 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin Strengthening Witness Protection in the Western Balkans – WINPRO III (NI-CO), ka realizuar trajnimin me temë “Mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që përmes prezantimit të praktikave më të mira dhe elaborimit të dilemave, pjesëmarrësit ti avancojnë njohuritë e pjesëmarrësve në lidhje me mbrojtjen më efektive të dëmtuarve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor.

Ky trajnim ka trajtuar mbrojtjen e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve si kategori të posaçme të cilat janë normuar në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës si dhe me Ligjin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, të cilat paraqesin kategori të rëndësishme në procesin penal.

Paraprakisht, vëmendje iu kushtua rasteve në praktikë, në disa prej të cilave sipas pjesëmarrësve të dëmtuarit dhe dëshmitarët nuk dëshmojnë për shkak të ndjenjës së rrezikut për shëndetin, jetën e tyre dhe anëtarëve të familjes. Kjo dëshmon se në procedurën penale, mbrojtjes së të dëmtuarit dhe dëshmitarëve duhet t’i kushtohet kujdesi i duhur që të njëjtit mos të kenë ndonjë ndërhyrje ose shqetësim eventuale nga jashtë dhe brenda.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor, zyrtarë policorë, bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarët ligjorë.



Të drejtat e të pandehurit nga ndalimi i parë deri në përfundim të procedurës penale

Më 12 prill 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnim të Vazhdueshëm ka realizuar trajnimin me temë “Të drejtat e të pandehurit nga ndalimi i parë deri në përfundim të procedurës penale”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve me të drejtat e të pandehurit nga ndalimi i parë deri në përfundim të procedurës penale, për respektimin e të drejtave të tij në praktikë, dhe format apo veprimet që duhet ndërmarrë për zbatimin konsekuent në praktikë të dispozitave ligjore që rregullojnë çështjen e këtyre të drejtave.

Gjatë trajnimit u trajtuan të drejtat e të dyshuarit respektivisht të pandehurit në procedurën penale sipas legjislacionit aktual për tu informuar në kohë sa më të shpejtë, në lidhje me veprën për të cilën dyshohet, akuzën dhe provat tjera, të cilat janë e drejtë themelore e tij.

Gjithashtu me qëllim të mbrojtjes së dinjitetit dhe të drejtave themelore të personave të dyshuar, është detyrë e institucioneve të drejtësisë që të kujdesen për garantimin dhe ruajtjen e të drejtave të personave të pandehur gjatë gjithë fazave të procedurës duke filluar nga arrestimi i të pandehurit e deri në përfundimin e procedurës.

Të pandehurit duhet të informohen me kohë dhe në hollësi mbi natyrën dhe shkakun e akuzimit kundër tij, dhe ti jepet kohë e mjaftueshme për të ushtruar të drejtat e tij të mbrojtjes në mënyrë efektive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor, zyrtarë policorë nga njësia e hetimeve.



Ndryshimet dhe risitë e Kodit të etikës Profesionale dhe Rregullorja për sjellje të pahijshme

Më 14 prill 2017, Akademia e Drejtësisë ka realizuar trajnimin me temë “Ndryshimet dhe risitë e Kodit të Etikës Profesionale dhe Rregullorja për Sjellje të Pahijshme”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me ndryshimet dhe risitë e Kodit të Etikës Profesionale dhe Rregullores për Sjellje të Pahijshme, për rritjen e besueshmërisë së qytetarëve për sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

Gjatë trajnimit u trajtuan ndryshimet dhe risitë e Kodit të Etikës Profesionale dhe Rregullores për përcaktimin e sjelljeve të pahijshme, të cilat rregullojnë respektimin e standardeve të sjelljes profesionale, respektimin e drejtë të ligjit dhe

përkujdesja e përhershme e gjyqtarëve dhe prokurorëve në përmbushjen e standardeve të njohura ndërkombëtare të sjelljes. Këto ndikojnë në ngritjen e standardeve më të larta të sjelljes gjyqësore dhe në forcimin e besimit të publikut ndaj gjyqësorit.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, me ç ‘rast u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike të përcjella me shembuj nga praktika.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë të nivelit themelor të regjioneve të ndryshme.



Bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë në çështjet penale

Më 19 prill 2017, Akademia e Drejtësisë ka realizuar trajnimin me temë “Bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë në çështjet penale”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me bashkëpunimin juridik ndërkombëtarë në çështjet penale, kur kemi të bëjmë me zbatimin sa më efikas të dispozitave ligjore në sigurimin e provave të ndryshme, në zgjidhjen e kërkesave për ndihmë juridike si dhe në çështjet e ekstradimit.

Në trajnim u trajtua bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë si nevojë, meqë krimi i ka tejkaluar kufijtë e brendshëm dhe ka marrë dimension ndërkombëtarë. Në një botë gjithnjë e më të ndërvarur, asnjë vend nuk mund të luftoj krimin në mënyrë efektive pa bashkëpunim në mes të shteteve për të parandaluar dhe për të

zbuluar krimin.

Për shkak të rrethanave në të cilat sot gjendet shoqëria njerëzore, sidomos për shkak të zgjerimit të mundësive që kanë kryesit e veprave penale për tejkalim të kufijve, gjyqtarët dhe prokurorët duhet të njihen me praktikatat efikase të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale, tematikë e cila u trajtua në kuadër të këtij trajnimi.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor si dhe bashkëpunëtorë profesional.



Trajtimi i rasteve të Dhunës në Familje

Më 19, 21 si dhe 27 prill 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, me mbështetjen e OSBE-së ka realizuar tri trajnime regjionale të ndara me temën “Trajtimi i rasteve të Dhunës në



Familje”, për regionet e Prishtinës, Gjilanit, Pejës dhe Gjakovës.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte që pjesëmarrësit të avancojnë njohuritë në lidhje me zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje për trajtimin e rasteve të dhunës në familje në mënyrë sa më profesionale.

Gjatë këtyre sesioneve trajnuese në mënyrë të hollësishme nga trajnuesit u trajtua formimi i rastit në fazën e hetimeve nga policia, përfshirja e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave, hetimet nga prokurori i shtetit si dhe faza e gjyqimit.

Dilemat e paraqitura gjatë trajnimeve kishin të bëjnë me pengesat që gjyqtarët hasin gjatë shqyrtimit të rasteve që kanë të bëjnë me

procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje si dhe zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore lidhur me procedurën dhe afatet për vendosje sipas kërkesave për urdhër mbrojtje.

Po ashtu, u diskutuan procedurat për vendosje sipas kërkesave për urdhër mbrojtje, llojet e masave mbrojtëse dhe kohëzgjatja e tyre, ekzekutimi dhe pasojat e mos ekzekutimit të urdhrimit për mbrojtje.

Trajnimet kishin për synim që përmes prezantimit të rasteve nga praktika gjyqësore dhe diskutimeve grupore, të ofrohen alternativa për problemet dhe vështirësitë praktike në lidhje me trajtimin adekuat të rasteve të dhunës në familje.



Përfitues të këtyre trajnimeve ishin gjyqtarët, prokurorët, bashkëpunëtorët profesional, përfaqësuesit nga policia që merren me rastet e dhunës në familje si dhe mbrojtësit e viktimave nga regjioni i Prishtinës, Gjilanit, Pejës dhe Gjakovës.



Pjesa e domosdoshme e trashëgimisë dhe cenimi i saj

Më 21 prill 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Pjesa e domosdoshme e trashëgimisë dhe cenimi i saj”.

Ky trajnim kishte për qëllim që gjyqtarët e fushës civile ti avancojnë njohuritë e tyre lidhur me pjesën e domosdoshme të trashëgimisë dhe cenimit të saj.

Në pjesën e parë të këtij trajnimi u trajtua pjesa e domosdoshme e trashëgimisë dhe trashëgimtarët e domosdoshëm si dhe llogaritja e pjesës së domosdoshme të trashëgimisë, ndërsa në pjesën e dytë, u trajtua cenimi i pjesës së domosdoshme dhe rrethi i trashëgimtarëve që kanë të drejtë në pjesën e domosdoshme.

Ky institut materialo - juridik i drejtës trashëgimore u trajtua gjithanshëm duke u dhënë përgjigje pyetjeve si: cila është pjesa e domosdoshme nga pasuria trashëgimore e trashëgimlënësit? Cilët janë trashëgimtarët e domosdoshëm? Cilat janë kufizimet e të drejtës së disponimit me pasurinë trashëgimore? Cila

është mënyra e llogaritjes së pjesës së domosdoshme? Çka është cenimi i pjesës së domosdoshme dhe mbrojtja gjyqësore?

Gjithashtu u trajtua edhe zbatimi i drejtë i dispozitave të Ligji për Trashëgiminë i Kosovës (LTK) që rregullojnë pjesën e domosdoshme, shembuj studimor, mbrojtja gjyqësore për shkak të cenimit të pjesës së domosdoshme si dhe raste nga praktika gjyqësore. Tematika e shqyrtuar ishte me interes duke marr për bazë numrin e rasteve dhe dilemave në praktikën gjyqësore që i referohen cenimit të pjesës së domosdoshme.

Në trajnim u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike të përcjella me shembuj të shumtë praktik, ku pjesëmarrësit ishin aktiv gjatë gjithë kohës.

Përfitues ishin gjyqtarët të Gjykatës së Apelit, gjyqtarët e divizioneve civile të departamenteve të përgjithshme në gjykatat themelore si dhe bashkëpunëtorët profesional.



Regjistrat e gjendjes civile, regjistrimi i mëvonshëm dhe ri-regjistrimi sipas Ligjit për Regjistrimin Civil

Më 28 prill 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Regjistrat e gjendjes civile, regjistrimi i mëvonshëm dhe ri-regjistrimi sipas Ligjit për Gjendjen Civile”.

Ky trajnim kishte për qëllim që gjyqtarët të avancojnë njohuritë e tyre lidhur me regjistrat e gjendjes civile, regjistrimin e mëvonshëm dhe ri-regjistrimin sipas Ligjit për Regjistrimin Civil.

Gjatë trajnimit u trajtuan çështjet lidhur me Regjistrat e gjendjes civile-korrigjimi dhe plotësimi në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile dhe regjistrimi i lindjes në bazë të dokumenteve bazë të lindjes, po ashtu u trajtuan çështje që kanë të bëjnë me regjistrimin e mëvonshëm dhe ri-regjistrimin si dhe raste nga praktika administrative dhe gjyqësore.

Në fokus të trajnimit ishte edhe zbatimi i drejtë i

dispozitave të legjislacionit primar dhe sekondar në fushën e regjistrimit dhe gjendjes civile, u zbërthyen procedurat që ndiqen në fushën e gjendjes civile, u identifikuan sfidat në relacionet gjykatë - Agjenci e Regjistrimit Civil si dhe u këmbyen përvoja ndërmjet regjioneve në Kosovë.

Në trajnim u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike të përcjella me shembuj praktik, ku pjesëmarrësit ishte aktiv gjatë gjithë kohës, duke marrë pjesë në diskutime me prezantuesin pas çdo shpjegimi.

Përfitues ishin gjyqtarët e divizionit civil dhe penal të departamenteve të përgjithshme në gjykatat themelore dhe bashkëpunëtorët profesional.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare (PTF)

Aktivitetet e realizuara në PTF– Prill 2017

Prill 2017, Akademia e Drejtësisë, me qëllim të realizimit të programit trajnues i planifikuar për muajin prill, ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të planifikuara në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, të cilin janë duke e vijuar prokurorët e shtetit të sapoemëruar.

Në këtë drejtim, në kuadër të trajnimit teorik janë realizuar edhe 2 sesionet e mbetura nga nën-moduli “Aktakuza - procedura e shqyrtimit”, me të cilat është përfunduar ky nën-modul, ku janë trajtuar: aktakuza me propozim për paraburgim, dhe sfidat e Prokurorit të Shtetit në aspektin e ekspertimit mjeko ligjor me rastin e ngritjes së aktakuzës.

Masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit, ishte nën-moduli tjetër i cili është përfunduar në këtë periudhë, nga i cili janë realizuar 6 sesione trajnuese dhe janë shtjelluar këto tema: kushtet ligjore për autorizimin e masave të fshehta dhe të drejtat e personave të atakuar, përgjimi i telekomunikimeve dhe regjistrimi i bisedave telefonike, hetimi i fshehtë dhe zbulimi i të dhënave financiare, shfrytëzimi i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, blerje e simuluar e sendit dhe simulimi i veprës së korrupsionit, kontrolli i

dërgesave postare dhe dërgimi i kontrolluar i dërgesave postare, si dhe vëzhgimi i fshehtë fotografik ose me video dhe monitorimi i fshehtë i bisedave.

Nën-modulet Krimet e Rënda dhe Procesverbalet po ashtu janë zhvilluar në këtë periudhë. Nën-moduli Krimet e rënda, është zhvilluar përmes 1 sesioni trajnues dhe janë shtjelluar këto tema: trafikimi me qenie njerëzore, pastrimi i parave dhe krimi kibernetikë. Ndërsa për nën-modulin Procesverbalet, janë realizuar 3 sesione trajnuese, ku ndër çështjet kryesore të trajtuara ishin: procesverbalet, krijimi dhe mbajtja e procesverbaleve, regjistrimi i seancave me incizim audio dhe me incizim audio dhe video, shikimi i procesverbalit dhe shkresave të lëndës.

Në kuadër të trajnimit praktikë, prokurorët e sapoemëruar kanë vazhduar praktikën në prokuroritë përkatëse konform orarit të përcaktuar me program, nën mbikëqyrjen e mentorëve të tyre, si dhe kanë vijuar trajnimet në këto institucione: Zyrën Kombëtare të Auditimit, Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe Administratën Tatimore të Kosovës.



Trajnimi praktikë në Zyrën Kombëtare të Auditimit

Më 05 prill 2015, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar me realizimin e trajnimeve fillestare në institucionet jo gjyqësore si pjesë e programit trajnues. Në këtë drejtim, për prokurorët e sapoemëruar, është realizuar trajnimi në Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Qëllimi i realizimit të këtij trajnimi konsistonte në rëndësinë që prokurorët e sapoemëruar të njoftohen me rolin, fushë-veprimtarinë dhe punën praktike të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Fillimisht në kuadër të këtij trajnimi u pasqyrua misioni dhe mandati i Zyrës Kombëtare të Auditimit, standardet ndërkombëtare në këtë fushë, puna praktike si dhe sfidat dhe vështirësitë me të cilat

ballafaqohet ky institucion në drejtim të ushtrimit të përgjegjësive të përcaktuara me ligj.

Në drejtim të kësaj, diskutimet u fokusuan në trajtimin e legjislacionit penal, që rregullon këtë materie, përkatësisht nenet respektive nga Kodi Penal, format aktuale të bashkëpunimit mes Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe mundësitë e bashkëpunimit me prokurorët e sapoemëruar në të ardhmen.

Përfitues të trajnimit ishin prokurorët e shtetit të sapoemëruar, gjenerata VI e PTF-së.



Trajnim praktik në Institutin e Mjekësisë Ligjore

Më 13 prill 2017, Akademia e Drejtësisë ka realizuar trajnimin praktik, për prokurorët e shtetit të sapoemëruar, në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Prishtinë.


Trajnimi synonte që prokurorët e sapoemëruar të avancojnë njohuritë e tyre rreth mandatit ligjor, përgjegjësi dhe rolit të Institutit të Mjekësisë Ligjore në funksion të ofrimit të mbështetjes për punën e prokurorëve, në rastet e trajtimit të lëndëve të kësaj natyre.

Fillimisht u pasqyrua në mënyrë të përgjithshme organizimi dhe struktura organizative e IML-së, baza ligjore mbi të cilën funksionon ky institucion si dhe sfidat aktuale me të cilat ballafaqohet në drejtim të ushtrimit të mandatit ligjor.

Më tej u shtjellua roli dhe rëndësia e mjekësisë ligjore për një proces penal, objektet e ekspertimit dhe investigimi mjeko ligjor dhe metodat tekniko-shkencore të investigimit mjeko ligjor.

Prokurorët e sapoemëruar kishin mundësinë që, për së afërmi të shohin punën praktike të IML-së, duke e vizituar në këtë formë ambientet e tij, si dhe duke përcjellë për së afërmi procesin e realizimit të një autopsie.

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së VI të PTF-së.



Trajnimi praktik në Administratën Tatimore të Kosovës

Më 19 prill 2017, në kuadër të trajnimeve praktike në institucionet jo-gjyqësore, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Administratën Tatimore të Kosovës, ka realizuar trajnimin për prokurorët e sapoemëruar në këtë institucion.

Qëllimi i këtij trajnimi konsistonte në faktin që prokurorët e sapoemëruar të thellojnë njohuritë e tyre lidhur me rolin, përgjegjësitë dhe punën praktike të Administratës Tatimore të Kosovës.

Në këtë trajnim fillimisht u pasqyrua misioni dhe vizioni i ATK-së, struktura organizative dhe sfidat aktuale me të cilat ballafaqohet ATK, në drejtim të përmbushjes së mandatit të saj. Me tej u trajtua legjislacioni i aplikueshëm tatimor në Kosovë, normat dhe llojet e

tatimeve, procedurat e aplikueshme në ATK, si dhe çështje tjera që ndërlidhen me punën praktike të prokurorëve dhe lëndët e kësaj natyre me të cilat do të ballafaqohen në praktikë.

Trajnimi ishte i karakterit interaktiv në çdo fazë të tij, me ç' rast prokurorët e sapoemëruar, bashkërisht me zyrtarët nga ATK-së, diskutuan për çështjet e interesit të përbashkët, me qëllim vendosjes së bazave të para të bashkëpunimit reciprok.

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorët e sapoemëruar të gjeneratës së VI të PTF-së.



Aktivitetet tjera

Vizita e delegacionit të Shkollës së Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë

Me datë 6-7 prill 2017, në kuadër të bashkëpunimit të rregullt, në Akademinë e Drejtësisë kanë qëndruar për një vizitë pune përfaqësuesit më të lartë nga Shkolla e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë si dhe ekspertë tjera nga fusha gjyqësore.



Në ditën e parë të vizitës delegacionin e priti z. Besim Morina, u.d. Drejtor i Akademisë së Drejtësisë së bashku me drejtuesit e departamenteve, i cili përfaqësuesit nga Shkolla e Magjistraturës i njoftoi nga afër me procesin e transformimit të Institutit Gjyqësor të Kosovës në Akademi të Drejtësisë, organizimin, funksionet dhe kompetencat bazuar në Ligjin për Akademinë e Drejtësisë.

Qëllimi i vizitës ishte intensifikimi i bashkëpunimit në mes të dy institucioneve të trajnimit gjyqësor, si dhe ndarja e përvojave në tejkalimin e sfidave të cilat paraqiten veçanërisht në fazat e reformave gjyqësore. Në këtë aspekt Drejtorët e institucioneve respektive shprehen gatishmërinë dhe vullnetin e tyre për angazhim të mëtutjeshëm në hartim të programeve konkrete të shkëmbimit si të gjyqtarëve dhe prokurorëve, po ashtu edhe të trajnuesve të këtyre institucioneve.

Sipas agjendës delegacioni ka zhvilluar takime edhe me përfaqësues të institucioneve të gjyqësorit ku janë pritur nga z. Blerim Isufaj, Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe z. Hasan Shala, Kryetar i Gjykatës së Apelit.

Delegacioni nga Shkolla e Magjistraturës zhvilloj takime edhe me Udhëheqësit e Programeve të Trajnimit Fillestar dhe të Vazhdueshëm, për t'u njoftuar me procesin e trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve veçanërisht ata të sapoemëruar dhe rrjedhën e trajnimit të vazhdueshëm.



Trajnim i Trajnuesve për Lirinë e shprehjes

Më 25-26 prill 2017, zyrtarë të Akademisë së Drejtësisë kanë marrë pjesë në Trajnimin e Trajnuesve për Lirinë e Shprehjes i organizuar nga projekti “Përforcimi i Ekspertizës Gjyqësore mbi Lirinë e Shprehjes dhe Medias në Evropën Juglindore – JUFREX”.

Qëllimi i trajnimit ishte zhvillimi dhe avancimi i aftësive të trajnuesve në realizimin e trajnimeve interaktive bazuar në ushtrimet e propozuara në Manualin e Trajnimit të përgatitur në kuadër të projektit JUFREX.

Trajnimi rajonal i trajnuesve u mundësoi pjesëmarrësve që t’i përmirësojnë dhe forcojnë kompetencat e tyre në hartimin dhe drejtimin e programeve edukative në bazë të kurrikulave model dhe manualit të projektit si dhe për t’i përshtatur këto kurrikula në kontekstin lokal të shteteve përkatëse.

Më tej në përdorimin e burimeve dhe mjeteve në dispozicion gjatë trajnimeve, zhvillimin e kapaciteteve të tyre në kryerjen e trajnimeve në mënyrë neutrale, përcjelljen e njohurive të tyre në fushën e lirisë së shprehjes tek pjesëmarrësit e trajnimeve si dhe për të kuptuar dhe lehtësuar proceset individuale dhe grupore të të mësuarit në fushën e lirisë së shprehjes.

Ky trajnim ka përfshirë pjesëmarrësit më të suksesshëm nga gjashtë trajnimet e mbajtura në vendet e ndryshme të rajonit, me qëllim që të krijohet një forum për shkëmbimin e përvojave të tyre në të ardhmen.

Përfitues të trajnimit ishin trajnuesit nga gjashtë vende të rajonit.



Takimi i Komitetit Drejtues i projektit “Përforcimi i Ekspertizës Gjyqësore mbi Lirinë e Shprehjes dhe medias në Evropën Juglindore - JUFREX”

Me 26 prill 2017, në Durrës të Shqipërisë është mbajtur Takimi i Komitetit Drejtues i projektit “Përforcimi i Ekspertizës Gjyqësore mbi Lirinë e Shprehjes dhe medias në Evropën Juglindore – JUFREX”.

Qëllimi i takimi të Komitetit Drejtues ishte diskutimi i aktiviteteve të deritanishme të programit të zbatuara gjatë vitit të parë të projektit, hartimi i plani të punës për vitin e ardhshëm në rrafshin lokal dhe rajonal, diskutimi i sfidave që projekti ka hasur gjatë zhvillimit dhe implementimit të aktiviteteve deri tani, sfidat që mund të paraqiten në të ardhmen si dhe shkëmbimi i ideve dhe propozimeve të reja.

Gjatë takimit janë prezantuar komponentët e projektit JUFREX që në fokus kanë lirinë e

shprehjes. Komponenti i parë në fokus ka programet e trajnimit me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve për lirinë e shprehjes të gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve, si dhe dy komponentët tjera që lidhen me Autoritetet Rregullatorë dhe Akterët e Medias.

Në takim të pranishëm ishin përfaqësuesit e Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës, stafi i projektit JUFREX nga rajonet si dhe përfaqësuesit e të gjitha Akademive të Drejtësisë nga rajoni.

Në këtë takim i cili është organizuar nga Këshilli i Evropës, ka marrë pjesë edhe përfaqësuesi i Akademisë së Drejtësisë së Kosovës.



Takimi i dytë i Rrjetit të Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të Evropës Juglindore

Me 26 - 27 prill 2017, përfaqësuesit e Akademisë së Drejtësisë kanë marrë pjesë në Takimin e Dytë të Rrjetit të Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të Evropës Juglindore i organizuar nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, i cili u mbajt në Stamboll.

Qëllimi i këtij takimi ishte prezantimi dhe diskutimi i strukturës organizative të institucioneve të trajnimit gjyqësor, organet menaxhuese, pikat e forta dhe të dobëta të funksionimit si dhe praktikat më të mira në këtë drejtim.

Gjithashtu u diskutua për nevojat e institucioneve trajnuese në fushën e trajnimeve gjyqësore dhe mbështetjen e pavarësisë së këtyre institucioneve, si dhe mundësinë që Këshilli për Bashkëpunim Rajonal të shërbej si një qendër për trajnime gjyqësore të qëndrueshme në vendet e Evropës Juglindore.

Në këtë takim u prezantuan aktivitetet konkrete të Këshillit për Bashkëpunim

Rajonal, si dhe u diskutuan dhe shkëmbyen propozimet për aktivitetet e ardhshme të përbashkëta të institucioneve për trajnim gjyqësor, nëpërmjet Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, siç janë studimet e ndryshme, trajnimet për gjyqtarë dhe prokurorë si dhe stafin e institucioneve trajnuese.

Takimi shërbeu edhe për të diskutuar projektet më të rëndësishëm në fushën e trajnimeve gjyqësore, ku u prezantuan sfidat dhe praktikat e mira në zbatimin e këtyre projekteve.

Po ashtu në këtë takim janë diskutuar edhe rezultatet e pritura në të ardhmen në nivel rajonal si dhe roli i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal për mbështetjen në ngritjen e kapaciteteve dhe forcimin e bashkëpunimit të institucioneve për trajnimin gjyqësor.



Nga Instituti Gjyqësor në Akademinë e Drejtësisë – Planifikimi strategjik për arsimin ligjor të gjyqësorit të Kosovës

Me 28 prill 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin e Binjakëzimit "Mbështetje e mëtutjeshme e reformës për arsimim ligjor" i financuar nga BE, realizoi një punëtori me temë "Nga Instituti Gjyqësor në Akademinë e Drejtësisë – Planifikimi strategjik për arsimin ligjor të gjyqësorit të Kosovës".



Qëllimi i kësaj punëtorie ishte Planifikimi Strategjik për arsimim ligjor të gjyqësorit të Kosovës nga Akademia e Drejtësisë.

Me rastin e kësaj punëtorie nga ekspertët e këtij projekti janë diskutuar elementet thelbësore të strategjisë për trajnimin dhe arsimin ligjor nga perspektiva e vendeve të BE-së e po ashtu është analizuar dhe diskutuar trajnimi gjyqësor në Kosovë. Në këtë drejtim u prezantua koncepti i planit strategjik për arsimimin ligjor në Kosovë me ç' rast janë pasqyruar vlerat, parimet dhe objektivat mbi të cilat duhet të udhëhiqet Akademia e Drejtësisë.

Gjatë punëtorisë pjesëmarrësit janë ndarë në tri grupe. Grupi i parë ka pasur për fokus politikatat e trajnimit - burimet dhe qëllimet e KGJK-së dhe KPK-së sa i përket zhvillimit të burimeve njerëzore, grupi i dytë në fokus kishte nevojat dhe kërkesat për orientimin në praktikë në kuadër të trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm, ndërkaq grupi i tretë ishte i orientuar në diskutime lidhur me vlerësimin e nevojave të trajnimit, trajnimin e trajnuesve dhe përdorimin e teknologjisë informative.

Në fund është bërë përmbledhja e rezultateve të grupeve punuese të cilat do të merren parasysh në punëtoritë e radhës me qëllim të finalizimit të Planit Strategjike të Akademisë.

Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin Kryesuesi i KGJK-së, përfaqësues nga KPK, gjyqtarë, prokurorë, dhe stafi menaxhues i Akademisë së Drejtësisë.



<https://ad.rks-gov.net>

**Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660
Fax: + 381 38 512 095
E-mail: infoad@rks-gov.net**